



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 119
Prishtinë, më 12 korrik 2010, në orën 11:00

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 12 KORRIK 2010**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 65 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e seancës.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010.

1. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Kryetari i informoi deputetët se komisionet kryesore dhe komisioni përgjegjës raportues - Komisioni për Buxhet e Financa – e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime, për miratim.

Ai ftoi përfaqësuesin e komisionit përgjegjës raportues që ta arsyetojë raportin para deputetëve të Kuvendit.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, paraqiti arsyetimin e raporteve të projektligjeve, në pako, që i kishte shqyrtuar ky komision. Ai tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka shqyrtuar propozimet e Qeverisë lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike, të Ligjit për ndryshimin e Ligjit të akcizës, të Ligjit për Bankën Qendrore dhe të Ligjit për Administratën Tatimore dhe bashkërisht me rishikimin e buxhetit i ka rekomanduar Kuvendit që në këtë seancë t'i miratojë amendamentet, respektivisht t'i miratojë këto ndryshime, në mënyrë që të përafrohemi me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Për sa i përket rishikimit të buxhetit, ne i kemi pasur limitet e përcaktuara dhe në këto nuk kemi mund të bëjmë ndryshime të mëdha, përpos disa rregullimeve brenda organizatave buxhetore. Prandaj, në përgjithësi, përpos pjesës që është shtuar për autostradën, nisjes së punimeve në autostradë, buxheti është i njëjti me ndryshime të vogla brendapërbrenda organizatave buxhetore. Ne nuk kemi pasur atë të drejtë të bëjmë bartje të mjeteve nga një linjë buxhetore në linjën tjetër buxhetore, si në strukturën e përgjithshme të buxhetit nga mallrat e shërbimet te pagat ose nga pagat e mallrat te shërbimet dhe kështu me radhë. E kemi pasur edhe të kufizuar shtimin e numrit të punëtorëve që përfitojnë nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe mendoj që këto janë në kuadër të kornizës së kërkuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.

Prandaj, në emër të Komisionit për Buxhet e Financa, ju ftoj që t'i miratojmë këto ligje.

Pastaj, kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Buxhet e Financa.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16.

Në fund, kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për----- 70;
Kundër----- 2.
Abstenime-----11.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë

Kryetari i informoi deputetët se komisionet kryesore dhe komisioni përgjegjës raportues - Komisioni për Buxhet e Financa – e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime, për miratim.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Buxhet e Financa.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2 dhe 3.

Në fund, kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për----- 65;
Kundër----- 18.
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat

Kryetari i informoi deputetët se komisionet kryesore dhe komisioni përgjegjës raportues - Komisioni për Buxhet e Financa – e kanë shqyrtuar Projektligjin për Administratën Tatimore dhe procedurat dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime, për miratim.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Buxhet e Financa.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Në fund, kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për-----73;
Kundër-----4.
Abstenime-----12.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për Administratën Tatimore dhe procedurat.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryetari i informoi deputetët se komisionet kryesore dhe komisioni përgjegjës raportues - Komisioni për Buxhet e Financa – e kanë shqyrtuar Projektligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime, për miratim.

Kryetari i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Buxhet e Financa.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48 dhe 49.

Në fund, kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për-----83;
Kundër-----4.
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010

Kryetari i informoi deputetët se komisionet kryesore dhe komisioni përgjegjës raportues - Komisioni për Buxhet e Financa - e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010 dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime, për miratim.

Kryetari i Komisionit për Buxhet e Financa, **Gani Koci**, e arsyetoi Raportin me amendamentet e propozuara.

Kryetari i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Buxhet e Financa. Kuvendi miratoi amendamentet:1, 2, 3, 4,5, 6, 7,8, 9,10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27.

Kryetari, në vazhdim hodhi në votim, veç e veç, rekomandimet e Komisionit për Buxhet e Financa për tri organizata buxhetore: për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Rezultatet e votimit të rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, ishin si vijon:

Për-----79
Kundër-----7
Abstenime-----5.

Rezultatet e votimit të rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ishin si vijon:

Për-----73
Kundër-----13
Abstenime-----4.

Rezultatet e votimit të rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ishin si vijon:

Për-----73
Kundër-----13
Abstenime-----4.

Në fund, kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për-----71
Kundër-----17
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 12:16 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup RASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale